REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.2785/1prot.

Përmet, më 04.11.....2024

Lënda: Kthim përgjigje

Organizata "Faktoje.al"

Rr. "NASI PAVLLO", Pallati "EDIL-AL", SH 1, Kati 3, AP 8.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar,lidhur me kërkesën për informacion protokolluar me tonën Nr.2785 Prot, datë 23.10.2024 ju vëmë në dispozicion kthim përgjigjet si më poshtë:

1. Plani i Kujdesit Social 2024-2027 është hartuar nga Bashkia Përmet në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbeshtetjen teknike të Programit të Kombeve të Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP. Plani është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 79 datë 23.10.2024.

2.Bashkia Përmet si çdo vit që hapet thirrja nga Fondi Social ka aplikuar me projektpropozim. Për vitin 2024 thirrja është mbyllur më datë 25 Tetor dhe ende nuk janë shpallur rezultatet.

3. Për aplikimin e këtij viti, Bashkia Përmet ka mbështetur kategori të ndryshme vulnerabël duke përfshirë të moshuar të vetmuar, persona në vështirësi ekonomikë, persona me aftësi të kufizuar etj duke ofruar kujdes shoqëror dhe një vakt ushqimor. Fondi total për vitin e parë të zbatimit shkon rreth 8 000 000 lekë.

4.Fondi i kushtëzuar i MSHMS është disbursuar në masën 100%.

5. Për vitin 2023, Bashkia Përmet ka aplikuar gjithashtu por nuk është shpallur fituese. Kategoria që do të mbështetej ishin fëmijët, të moshuarit dhe gratë kryefamiljare. Gjithashtu është aplikuar njëkohësisht edhe në thirrjen e UNDP, prej të cilës kemi përfituar ofrimin e shërbimit të asistencës në shtëpi për të moshuarit e vetmuar, si shërbim infermieror, psikolog dhe përfshirje sociale në jetën social-kulturore të moshës së tretë duke rijetëzuar Qëndrën Ditore të të moshuarve. Fondi i përfituar është në vlerën rreth 3 000 000 lekë (të reja).

6. Nuk kemi patur fond të përfituar nga Fondi Social, ndërsa nga fondi i projektit të UNDP deri tani janë shpenzuar rreth 30% të fondeve të alokuara nga transhi i parë.

Bashkia Përmet ka parashikuar në [illegible] ajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të [illegible] Social.

8. Kategoritë e shtresave vurnerabël të identifikuar në bashkinë tone që përfitojnë nga shërbimet sociale janë: të moshuar të vetmuar, persona apo fëmijë me aftësi të kufizuara, gra të dhunuara, komuniteti Egjiptian, familjet e pastreha, fëmijë në situatë rruge, përsona në vështirësi ekonomike etj.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA